



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1539/7 Prot.,

Datë 20.09.2021

V E N D I M

Nr. 647/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.09.2021 me:

Objekt:

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-02824-08-13-2021, me objekt “*Ndërtimi i linjës kabllore 110 kV, Qendër - Tirana1 si dhe trakti 110 kV në funksion të kesaj linje*”, me fond limit 136,184,120 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SH.A.).

Ankimues:

“Aci Engineering” SHPK

Rruga: “Abdyl Frashëri”, Nd. 8,H.13, Ap.7 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SH.A.)

Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës
Km. 9.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë
19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik
Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e
rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e
Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit
të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë
5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave
Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së
Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë
gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.08.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-02824-08-13-2021, me objekt “Ndërtimi i linjës

kabllore 110 kV, Qendër - Tirana1 si dhe trakti 110 kV në funksion të kesaj linje”, me fond limit 136,184,120 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

II.2. Në datën 20.08.2021 operatori ekonomik “Aci Engineering” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1539/2 prot., datë 25.08.2021 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Aci Engineering” SHPK.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 5029/4 prot., datë 24.08.2021, protokolluar me tonën me nr. 1539/3 prot., datë 27.08.2021 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK dhe me vendimin nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. (pika 2 e ankesës të publikuar në bazën e të dhënave të Komisionit të Prokurimit Publik). Konkretisht, ankimuesi në pikën 2 të ankesës ka ankimuar konkretisht:

“[...]Ajo që bën përshtypje në Kriteret e Kualifikimit të hartuara nga Enti Prokurues është se ndërkohë që futet si kriter eliminues një sondë robotike e panevojshme, lihen jashtë kërkesave “freza qeruese e gjysëm përcuesit të kabllit” pa të cilin as që cohet në mend të realizohet xhunto ose terminali 100kv, apo në tufë me pajisje të tjera që përdoren për xhuntim apo montim terminalesh 110 kv. Ndërkohë që mungojnë kërkesa Trapani dhe Pincat!!!!

Ndaj kërkojmë nga enti prokurues që të reflektojë duke shtuar në listën e makinerive dhe pajisjeve edhe pajisjet e domosdoshme për të realizuar xhuntimin dhe terminialet 110kv sepse mungojnë.[...]”

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se kjo pikë e ankesës është pranuar si vijon: *“[...] Nga sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues është e nevojshme që ofertuesi të disponojë edhe “frezë qëruese e gjysëm përcuesit të kabllit”, konsiderohet nga KSHA si mjet i nevojshëm, megjithëse kjo kontratë është parashikuar të realizohet me “celësa në dorë”, si dhe disponimi i kësaj pajisje nga ofertuesi për realizimin e kontratës nuk ndikon në anën financiare të AK-së. Si rrjedhim me anë të një shtojce të dokumenteve të tenderit do të kërkohet dhe kjo pajisje që sugjeron oe ankimues[...]*”.

II.7. Nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr. 1539/4 prot., datë 27.08.2021 me objekt *“Argumente mbi ankesën”*, operatori ekonomik *“Aci Engineering”* SHPK ka paraqitur argumentet pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 5140/1 prot., datë 30.08.2021 protokolluar me tonën me nr. 1539/5 prot., datë 31.08.2021 me objekt *“Informacion”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin 558/2021 datë 31.08.2021 ka vendosur:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr. REF-02824-08-13-2021, me objekt “Ndërtimi i linjës kabllore 110 kV, Qendër - Tirana1 si dhe trakti 110 kV në funksion të kesaj linje”, me fond limit 136,184,120 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit te Transmetimit OST.*
- 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.*
- 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Aci Engineering” SHPK për modifikimin e kriterit në mënyrë të përmbledhur si vijon:

“[...]Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.10 është kërkuar mjete “Makineri vetëlëvizëse për shpime horizontale nentoksore për kalimin e kabllit pa demtuar asfaltin e kompletuar (SET)”. Duke iu referuar projekt preventiv ky mjet nuk është i nevojshëm të vendoset, sepse nuk ka asnjë zë preventiv për punimet që do të kryejë mjete Makineri vetëlëvizëse për shpime horizontale nentoksore për kalimin e kabullit pa demtuar asfaltin e kompletuar (SET). Nisur nga eksperiencia jonë që në rrjetet kabllore 110kV është unike në Shqipëri, si dhe duke njohur mirë edhe rrjetin ekzistues 110kV të po këtij nënstacioni 110kV Tiranë Qendër (pasi kemi qenë furnizuesit dhe implementuesit e tij në vitin 2011) si dhe të rrjeteve kabllore 20kV që kalojnë në tunelin e kablove në bulevard ku parashikohet të kalojë edhe ky kabull 110kV, na rezulton që një pajisje e tillë nuk është e nevojshme, pasi nuk ka mundësi të përdoret në asnjë vend të këtij projekti. Mos flasim këtu për pamundësinë reale për ta përdorur këtë sondë në mes të Tiranës. Drejtoria e Prokurimeve që e ka vendosur këtë kusht nuk e ka idenë se si përdoret kjo makineri. Ndërkaq, këtë shpjegim nuk e gjejmë as në argumentimin e Drejtorisë së Prokurimit për nevojën e përdorimit të kësaj sonde robotike. Nga ana tjetër në dijeninë tonë si kompani eksperte në rrjetet kabllore në Shqipëri një sondë e tillë robotike nuk disponohet sot në tregun shqiptar, edhe një njësi që ka qenë në përdorim është rikthyer në Kosovë. Rrjedhimisht, kur nga një anë është e panevojshme dhe kur nga ana tjetër nuk gjendet, shtimi i kësaj kërkesë si kriter eliminues na krijon idenë e një kriteri diskriminues me qëllime të paqarta por edhe me rreziqe për përfundimin me sukses të këtij projekti. Për arsyet e mësipërme kërkojmë nga Enti Prokurues heqjen e kësaj kërkesë, [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.10 “Për Kapacitetin teknik” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.10. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, kërkohen si më poshtë:

<i>Ofertuesi duhet të disponojë këto makineri:</i> Makineri dhe pajisje	Nr.	Njësia
<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton</i>	4	<i>copë</i>
<i>Autovinç</i>	2	<i>copë</i>
<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës minimalisht 3.5 ton – 5 ton</i>	2	<i>copë</i>
<i>Fadrom me goma</i>	3	<i>copë</i>
<i>Eskavator me zinxhirë (kapaciteti 7 ton deri 8 ton)</i>	1	<i>copë</i>
<i>Eskavator me zinxhirë me çekiç (kapaciteti 20 ton deri 25 ton)</i>	1	<i>copë</i>
<i>Minieskavator (kapaciteti 3.5 ton deri 5.5 ton)</i>	2	<i>copë</i>

<i>Minieskavator me zinxhirë me çekiç (kapaciteti 2.5 ton deri 3 ton)</i>	1	copë
<i>Rrul gome – hekur (kapaciteti 7 ton deri 7.5 ton)</i>	1	copë
<i>Rrul hekur – hekur (kapaciteti 7 ton deri 7.5 ton)</i>	1	copë
<i>Vibrator betoni</i>	2	copë
<i>Matrapik</i>	1	copë
<i>Gjenerator ≥ 5kw</i>	1	copë
<i>Elektrogur</i>	2	copë
<i>Trapan</i>	4	copë
<i>Pinca</i>	5	copë
<i>Shkallë Alumini</i>	2	copë
<i>Balandeze 25 m</i>	2	copë
<i>Kokore</i>	20	copë
<i>Jelek</i>	20	copë
<i>Doreza pune</i>	20	copë
<i>Makineri vetëlëvizëse për shpime horizontale nëntoksore për kalimin e kabllit pa dëmtuar asfaltin e kompletuar (SET):</i> <ul style="list-style-type: none"> <i>- Veglat për shpime në shkëmb apo në tokë, me pjesën punuese.</i> <i>- pjese për kontrollimin e makinerise së shpimit.</i> <i>- Automjete transporti mallrash, me motor diezel paisje për tuba çeliku për shpime horizontale nëntokësore</i> <i>- Automjet transporti mallrash, me peshe mbajtëse deri 5 Ton,</i> <i>- Dirigjues që e vë në funksion makinën për shpime horizontale nëntokësore.</i> <i>- Raketë për shpime horizontale që i montohet makinës për shpime horizontale.</i> <i>- Kokë shpuese me sistem laserik të kontrollit me pjesë</i> <i>Përcjellëse</i>	1	set

Si deshmi per plotesimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- a)** *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe leje transporti.*
- b)** *Për mjetet e siguruara me qira, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe leje transporti, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qirasë/furnizimit e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publikë duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.*

Shënim: Për pikën si më sipër operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së kontratës, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër”.

III.1.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjisllacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e 48 duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.1.3. Në pikat 1, 4 dhe 6 të nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Punët publike mund të prokurohen:

a) me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projektpreventiv mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti/enti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

b) me kontratë me çelësa në dorë:

i. Ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

ii. Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projektpreventiv, por ka vetëm një projektide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron.

Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projektpreventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Autoriteti/enti kontraktor duhet të kërkojë nga ofertuesit disponimin e kapaciteteve teknike për realizimin e secilës fazë të sipërcituar: për hartimin e projektit, si dhe për realizimin e tij, duke lejuar edhe mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, sipas projektpreventivit të miratuar paraprakisht nga autoriteti kontraktor, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Së pari, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se nga të dhënat e administruara në dosje, kjo është një kontratë pune me çelsa në dorë dhe sipas nenit 39, pika 1/b/i, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projektpreventiv, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast, kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi. Gjithashtu, dokumentet e tenderit nuk kanë asnjë detaj apo projekt të detajuar mbi mënyrën e zhvillimit të punime civile për shtrirjen e kabllave 110kV në të gjitha seksionet e kërkuara I-VI.

Së dyti, referuar përshkrimit të punimeve civile sipas specifikimeve teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, nuk është përshkruar në lidhje me mosprishjen e të gjithë pjesës së asfaltit të rrugës ku do të kalojë kabulli 110kV, e cilësuar kjo tek shkresa “Vendim” nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021 drejtuar ankimuesit për të cilën lind nevoja e disponimit të një mjete të tillë. Gjithashtu, sipas specifikime teknike të autoritetit kontraktor, punimet civile për shtrirjen e kabullit 110kV do të jenë brenda “tombinove ekzistuese” sipas seksioneve të kërkuara. Ndërkohë dhe vetë autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë sqarim apo përshkrim të gjendjes ekzistuese të këtyre tombinove, në të cilat do të kalojë kabllik 110kv, ku dhe pretendohet të punohet me makinerinë vetëlëvizëse për shpime horizontale nëntoksore për kalimin e kabullit pa dëmtuar asfaltin e kompletuar, e cilësuar vetëm në shkresën “Vendim” nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021 drejtuar ankimuesit.

Së treti, autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe teknologji ekuivalente për të arritur qëllimin, pasi duke qenë kontratë me çelsa në dorë, ofertuesi mund të japë zgjidhje më ekonomike apo efikente për shtrirjen e kablllove 110kV në të gjitha seksionet e kërkuara I-VI, në trasenë e tuneleve të shërbimit, ku pjesa më e madhe e trasesë përfshin shtrimin në tunele ekzistuese, e përshkruar kjo edhe në specifikimet teknike të hartuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Në lidhje me pretendimin e ankimuesit për disponimin e makinerive/mjeteve, Komisioni i Prokurimit Publik për sa u argumentua më lart gjykon, se kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e mjetit në fjalë, konkretisht të “Makineri vetëlëvizëse për shpime horizontale nëntoksore për kalimin e kabullit pa dëmtuar asfaltin e kompletuar (SET)”, është një kërkesë diskriminuese dhe jo e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, pasi autoriteti kontraktor nuk ka dhënë argumente teknike, detaje të përshkruara, gjendje aktuale e tombinove ekzistuese apo sqarime mbi proceset e punëve civile lidhur me shtrirjen e kablllove 110kV. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se autoriteti kontraktor në procesverbalin më datë 13.08.2021 “*për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim*” dhe në shkresën “Vendim” nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021 drejtuar ankimuesit, nuk ka dhënë asnjë argument teknik lidhur me disponimin e mjetit “Makineri vetëlëvizëse për shpime horizontale nëntoksore për kalimin e kabullit pa dëmtuar asfaltin e kompletuar (SET). Për më tepër, autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë detaj apo përshkrim teknik mbi proceset e punëve civile lidhur me shtrirjen e kablllove 110kV, punime të cilat janë parashikuar për t’u realizuar brenda “tombinove ekzistuese” sipas seksioneve të kërkuara. Për sa më sipër, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit, duke hequr mjetin e sipërcituar në kriterin për kualifikim sipas konstatimit të shqyrtuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, me argumentin: “[...] Në kërkesat për kualifikim, tek seksioni i furnizimit të mallrave për artikujt “Xhunto 110Kv” dhe “Terminale 110kV” është kërkuar Autorizim Prodhuesi. Në fakt po ti referohesh Tabelës së Çmimeve, OST nuk ka kërkuar furnizim të Xhuntove dhe Terminaleve të reja 110kV por vetëm të Materialeve të Skaduara, pra vetëm të një pjese për **kitin e xhuntove (nr. 18) dhe për kitin e Terminaleve (Nr. 19)**. Këto fakte ne i kemi evidentuar edhe gjatë realizimit me sukses të kontratës nr. 2068/9 Prot., datë 19.06.2020 me objekt “Punime për përfundimin e linjës kablllore 110kV Tiranë-Selitë dhe lidhja me nënstacionin 110/20kV Kombinat” e cila u vu në punë me sukses prej kompanisë sonë pas 10 vjetësh përpjekje pa sukses të OST. Gjatë zbatimit të kësaj kontrate ne mësuam për këto skadencia të këtyre artikujve të cilat sot janë vendosur në artikujt 18 dhe 19. Por këto xhunto dhe terminale pra edhe elementët brenda tyre i takojnë vetëm 1 prodhuesi. Pra, praktikisht në kërkesën e Entit për Autorizim prodhuesi Enti Prokurues i dërgon kërkesat tek vetëm një prodhues, pasi asnjë prodhues tjetër nuk mund t’i plotësojë, pasi janë të dedikuara dhe kërkesa për adaptime mund të sjellë rreziqe të mëdha që këto xhunto dhe terminale

të plasën pasi të montohen, e që rrjedhimisht do të shoqërohen me rreziqe të rritura për OST. Pra, na rezulton që ky kriter për Autorizim Prodhuesi të jetë diskriminues pasi i dërgon të gjithë operatorët ekonomikë në vetëm 1 prodhues, atë që ka prodhuar këto xhunto dhe terminale 10 vjet më parë. Përveç se diskriminues për mendimin tonë ky kusht është edhe praktikisht i përealizueshëm. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.12 “Për Kapacitetin teknik” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.12 Për listën e mëposhtme të mallrave:

- *Kablo fuqie (sipas specifikimeve teknike).*
- *Mufte bashkuese për kabllot (sipas specifikimeve teknike).*
- *Terminale (sipas specifikimeve teknike).*
- *Shkarkues (sipas specifikimeve teknike).*
- *Kabull optik nëntoksor (sipas specifikimeve teknike).*

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

1. *Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

III.2.2. Në nenin 4 “Përkufizime” të ligjit nr.162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se: “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit”.

Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorhet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuar plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.2.3. Në pikën 4, të nenit 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike", të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", parashikon shprehimisht se: "4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".

III.2.4. Referuar kthim-përgjigjes drejtuar ankimesit rezulton, se autoriteti kontraktor lidhur me pretendimin sa më sipër ka argumentuar si vijon: “KSHA gjykon se meqënëse AK ka disa pjesë të magazinuara, për të cilat ajo ka shpenzuar një herë dhe i ka në gjendje pune, nuk ka arsye për mos ti përdorur ato për të realizuar investimet e nevojshme. Nuk ka kuptim që të lihen të magazinuara dhe të blihen të tjera, për sa kohë ato mund të futen në punë për realizimin e kësaj kontrate. **Konkretisht, elementët përbërës të xhuntove ekszituese duhet të jenë të të njëjtit prodhues “ose ekuivalent”, në mënyrë që ato të vihen në punë normalisht.** Në këtë mënyrë AK nuk i shtohen kosto shtesë për pasisje të cilat i disponon dhe janë blerë një herë. Për të mos patur kufizime, AK ka menduar që të pranojë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar, duke patur në këtë mënyrë, shumë mundësi alternative që OE ofertues të plotësojë këtë kriter të nevojshëm”.

III.2.5 Nga shqyrtimi në tërësi i pretendimit të operatorit ekonomik “Aci Engineering” SHPK rezulton, se sipas specifikimeve teknike dhe tabelës së artikujve nr. 18 “Materialet e skaduara për Kitin e Xhuntove” dhe nr. 19. “Materialet e skaduara për Kitin e terminaleve”, autoriteti kontraktor ka kërkuar, që për furnizimin e kabullit 110kV, do të bazohen në përdorimin e terminaleve dhe xhuntove ekzistuese 110kV, që ndodhen në magazinën e OST SHA si dhe blerjen e materialeve të skaduara që përmban kiti në mënyrë, që të ripërdoren dhe puna të kryhet me xhuntot dhe terminallet gjendje në magazinë e OST SHA. Ndërkohë ankimesi pretendon, që elementët brenda tyre i takojnë vetëm një prodhuesi, dhe kërkesa e autoriteti kontraktor për “Autorizim prodhuesi” orienton drejt një prodhuesi, pasi asnjë prodhues tjetër nuk mund t’i plotësojë elementet e skaduara të cilat janë të dedikuara dhe kërkesa për adaptime mund të sjellë rreziqe të mëdha që këto xhunto dhe terminale të plasim pasi të montohen, e që rrjedhimisht do të shoqërohen me rreziqe të rritura për OST SHA. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterit të veçantë të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Konkretisht, autoriteti kontraktor duhet të justifikojë ligjërisht termin “ose ekuivalent” të cilësuar në shkresën “Vendim” nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021 drejtuar ankimesit, në lidhje me *elementet përbërëse të xhuntove ekszituese duhet të jenë të të njëjtit prodhues “ose ekuivalent”,* shoqëruar kjo edhe me korrespondencën që mund të ketë autoriteti kontraktor me prodhuesin/it ose distributorin/ët e autorizuar, për elementet e skaduara të kiteve të xhuntove dhe të kiteve të terminaleve, për të cilat kërkohet që të blihen të reja, në mënyrë që ato të vihen në punë normalisht. Referuar sa më sipër, KPP e gjen të drejtë pretendimin e

operatorit ekonomik “Aci Engineering” SHPK në lidhje me paraqitjen e Autorizim prodhuesi/distributor i autorizuar për listën e mallrave të nr. 18 dhe nr.19 sipas preventivit. Për rrjedhojë KPP gjykon, se kriteri i veçantë i kualifikimit i cili përcakton paraqitjen e Autorizim prodhuesi/distributor i autorizuar për listën e mallrave të nr. 18 dhe nr.19 sipas preventivit, duhet të modifikohet nga autoriteti kontraktor duke e hequr si kërkesë ose në rastin kur është “ose ekuivalent” autoriteti kontraktor të përcaktojë cilët janë këto ekuivalentë të elementeve të kитеve të xhuntove dhe të kитеve të termianleve në mënyrë që, të shmanget çdolloj konfuzioni gjatë dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë të interesuar apo akoma më tej edhe për të lehtësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, me argumentin: *“[...] Në kërkesat për kualifikim, tek seksioni i furnizimit të mallrave për artikujt “Xhunto 110 kV” dhe “Terminale 110 kV” është kërkuar Katalogu dhe Dëshmi të testeve zyrtare. Në fakt po t’i referohesh Tabelës së Çmimeve, OST nuk ka kërkuar furnizim të Xhuntove dhe Terminaleve të reja 110kV por vetëm të materialeve të skaduara, pra vetëm të disa artikujve (nga 25-30 gjithsej që ka kiti) për kitin e xhuntove (Nr. 18) dhe për kitin e terminaleve (Nr. 19). Përderisa kërkesa është jo për produkt të ri por vetëm për Elementet e skaduara të tyre, rrjedhimisht rezulton e paarsyeshme edhe kërkesa për Katalog apo Dëshmi të testeve zyrtare, sepse këto elemente të brendshme që kanë skaduar as nuk jepen në katalog por as edhe nuk testohen veçmas, por vetëm si njësi e përfunduar pas montimit. Pra, na rezulton që ky kriter për Katalog dhe Dëshmi të Testeve zyrtare të jenë diskriminues, pasi i dërgon të gjithë operatorët ekonomik në vetëm një prodhues, atë që ka prodhuar këto xhunto dhe terminale 10 vjet më parë. Përveçse diskriminuese për mendimin tonë këto 2 kushte janë edhe praktikisht të porealizueshme. Ndërkohë, kemi edhe pyetjen, a mos ka parashikuar Enti Prokurues që gjatë zbatimit të kontratës t’i zëvendësojë këto artikuj Nr. 18 dhe Nr. 19 me xhunto të reja në rast se kontraktori do rezultojë që nuk do t’i sigurojë dot këto artikuj ose do rezultojë me rrezik përdorimi i tyre? Ndaj kërkojmë më shumë qartësi nga Drejtoria e Prokurimeve, sepse këto janë probleme që do t’i dalin kujtdo kontraktori gjatë zbatimit. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.12 “Për Kapacitetin teknik” nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.12 Për listën e mëposhtme të mallrave:

- *Kablo fuqie (sipas specifikimeve teknike).*
- *Mufte bashkuese per kabllo (sipas specifikimeve teknike).*
- *Terminale(sipas specifikimeve teknike).*
- *Shkarkues (sipas specifikimeve teknike).*
- *Kabull optik nëntoksor (sipas specifikimeve teknike).*

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

2. Katalog/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhenat teknike bazë të përkthyer në gjuhën shqipe. Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë *dëshmi të testimeve zyrtare të kryera*, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi të kryera me parë, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme ose të ngjashme) me specififikimet teknike dhe standartet e kërkuara”.

III.3.2. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e 48 duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.3.3. Në pikën 4, të nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.3.4. Referuar kthim përgjigjes drejtuar ankimuesit rezulton se autoriteti kontraktor lidhur me pretendimin sa më sipër ka argumentuar si vijon: “Për sa i përket katalogut dhe dëshmive të testimeve zyrtare të kërkuara, për sa u arsyetua më sipër për xhuntot dhe terminalet, AK duhet të verifikojë me anë të katalogut dhe testimeve zyrtare për këto pajisje të ofertuara nga OE ofertues janë në përputhje teknike apo jo me pajisjet ekzistuese që AK disponon, në mënyrë që kontrata

objekt prokurimi mos të ketë pengesa dhe vonesa të pajustificuara, të cilat janë kosto shtesë për AK dhe sistemin elektro-energjitik shqiptar”.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Sipas pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, për këto elemente të brendshme që kanë skaduar, as nuk jepen në katalog por as nuk testohen veçmas, por vetëm si njësi e përfunduar pas montimit. Konkretisht, autoriteti kontraktor duhet të justifikojë ligjërisht termin “ose ekuivalent” të cilësuar në shkresën “Vendim” nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021 drejtuar ankimuesit, në lidhje me *elementet përbërëse të xhuntove ekszituese duhet të jenë të të njëjtit prodhues “ose ekuivalent”*, shoqëruar kjo edhe me korrespondencën që mund të ketë autoriteti kontraktor me prodhuesit ose distributorët e autorizuar, për elementet e skaduar të kiteve të xhuntove dhe të kiteve të terminaleve, për të cilat kërkohet që të blihen të reja shoqëruar me katalogë dhe dëshmi të testeve zyrtare, në mënyrë që ato të vihen në punë normalisht. Për më tepër, autoriteti kontraktor kërkon që për këto elementë të rinj që do blihen, autoriteti kontraktor duhet të verifikojë me anë të katalogut dhe testeve zyrtare nëse janë në përputhje teknike apo jo me ato ekzistuese që disponon. Referuar sa më sipër, KPP e gjen të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik “Aci Engineering” SHPK në lidhje me paraqitjen e katalogëve dhe dëshmitë e testeve për listën e mallrave të nr. 18 dhe nr.19 sipas preventivit. Për rrjedhojë KPP gjykon, se kriteri i veçantë i kualifikimit i cili përcakton paraqitjen e katalogëve dhe dëshmitë të testeve zyrtare, për listën e mallrave të nr. 18 dhe nr.19 sipas preventivit, duhet të modifikohet nga autoriteti kontraktor duke e hequr si kërkesë ose në rastin kur është “ose ekuivalent” autoriteti kontraktor të përcaktojë cilët janë këto ekuivalentë të elementeve të xhuntove dhe terminaleve në mënyrë që të shmangët çdolloj konfuzioni gjatë dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë të interesuar apo akoma më tej edhe për të lehtësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Lidhur me pretendimin sa më sipër të ankimuesit të parashtruar në formën e kërkesës për sqarim nëse autoriteti kontraktor ka parashikuar që gjatë zbatimit të kontratës t’i zëvendësojë këto artikuj nr.18 dhe nr.19 me xhunto të reja në rast se kontraktori do rezultojë që nuk do t’i sigurojë këto artikuj ose do rezultojë me rrezik përdorimi i tyre, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk e ka sqaruar ankimuesin me anë të shkresës me lëndë “Vendim” me nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021, drejtuar operatorit ekonomik ankimues. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor si

organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre, nuk e ka sqaruar ankimesin në mënyrë shteruese mbi të gjitha pyetjet e ngritura, si dhe duhet të bëjë dhe publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 të LPP, i cili, parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”*, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimes me sqarimin për dokumentet e tenderit, për të qenë i qartë e i saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Aci Engineering” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, me argumentin: *“[...] Në kërkesat për kualifikim, tek Punët e ngjashme, kërkohet që si referencë të kontratave të ngjashme të jenë punime në linjat 110kV e më lart. Meqë nuk del aspak e qartë në argumentimin e bërë nga Drejtoria e Prokurimeve, dëshirojmë të theksojmë që linjat ajrore 110kV nuk kanë lidhje fare me linjat kabllore 110kV, as në materialet që përdoren, as në proceset e punës, as në makineritë që kërkohen, as në testet e aplikuara e as në personelin e zbatimit. E themi me siguri si ekspertë të kësaj fushe që kompani që mund të kenë bërë qindra km linja ajrore 110kV apo edhe 400kV të mos ja kenë haberin me linjat kabllore 110kV, Çështja është se deri më sot ka shumë pak raste të kompanive shqiptare që kanë ekspertizë për të bërë të tilla punë. Rasti i zgjidhjes vetëm pas 10 vjetësh të një projekti të mbetur përgjysëm që në 2011 flet shumë qartë për ato që kuptojnë nga kjo fushë specifike e Kabllorëve të Tensionit të Lartë. Ndaj edhe ky kriter na duket diskriminues dhe ftojmë Entin Prokurues të rishikojë duke konsideruar si eksperiencë të ngjashme linjat kabllore 110kV por edhe nënstationet elektrike të tensioneve 110kV e më lart, sepse në këto kriterë eksperiencë Drejtoria e Prokurimit nuk parashikon si eksperiencë të ngjashme as punimet në nënstatione 110kV kur edhe një pjesë mirë e po këtij projekti është nënstation 110kV. [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, në pikën 2.3.1 *“Për Kapacitetin teknik”* nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën:*

- b) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- c) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më të vogël se 190 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: Kontrata të ngjashme përsa i përket punimeve elektrike për vetë specifikën që kanë, do të konsiderohen punimet në Linjat elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV.

III.4.2. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e 48 duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.4.3. Në pikat 4 dhe 5 të nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikon

shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Lidhur me kundërshtimet e ankimesit sa i takon kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim për eksperiencë të ngjashme, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në hartimin e pjesës së parë të kriterit i është përmbajtur përcaktimeve të nenit 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Por në rastin konkret, KPP vëren se autoriteti kontraktor përveç kriterit të hartuar brenda kufijve që parashikojnë dispozitat ligjore lidhur me eksperiencën e ngjashme ka shtuar në fund të kriterit edhe frazën *Shënim: Kontrata të ngjashme për sa i përket punimeve elektrike për vetë specifikën që kanë, do të konsiderohen punimet në Linjat elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV.*

Sa më sipër, KPP gjykon, se në lidhje me hartimin e kriterit kualifikues për përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor t'i përmbahet dispozitës ligjore të parashikuar të pikës 5 të nenit 39 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021. Në këtë kuptim, KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen nga kriteri i veçantë i kualifikimit në pikën 2.3.1 të frazës ***Shënim: Kontrata të ngjashme për sa i përket punimeve elektrike për vetë specifikën që kanë, do të konsiderohen punimet në Linjat elektrike me nivel tensioni ≥ 110 kV***, në mënyrë që të shmangët çdolloj konfuzioni gjatë dorëzimit të ofertave nga operatorët ekonomikë të interesuar apo akoma më tej edhe për të lehtësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, me argumentin: “[...] Në pikën 12 të Tabelës së Çmimeve, seksioni II, është kërkuar: *Furnizim rezine epoxy per izolacionin e xhuntove te kablllove TL, ARE4H1H5E.....*

Kjo është tipi i xhuntos para 10 vjetësh për kabullin ekzistues të asaj kohe. Ndërkohë në këtë projekt të ri kabulli mund të mos jetë i po këtij tipi dhe kjo tip rezine mund të mos kryejë më këtë funksion. Ndaj duhet Drejtoria e Prokurimit ta sqarojë mirë këtë për të shmangur problematika në zbatimin e projektit. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentet e tenderit, seksioni II, shtojca 2, “*Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit*”, në **pikën 12** nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

LISTA E ÇMIMEVE Nr.1:

Punime civile dhe elektrike per ndertimin e linjes kablllore Tirana 1 - Qendër

<i>Nr</i>	<i>Nr. Analizë</i>	<i>Përshkrimi i Punëve</i>	<i>Njësi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi/ Njësi</i>	<i>Çmimi total</i>
<i>II. PUNIME ELEKTRIKE TE TERMINALEVE + MUFTAVE + TOKEZIMI I SKERMES SE KABLLOVE XLPE, AL, SIIx1000) mm2</i>						
12		<i>Furnizim rezine epoxy (reshire epokside), ngurtësues (hardener) + perberes baze per izolacionin e xhuntove te kablllove TL, ARE4H1H5E, AL, 110 kV, seksioni (1x1000) mm2(14,4 kg hardener + 48,6 kg perberes baze = 1 set)</i>	<i>Set</i>	21		

III.5.2. Neni 2, “Qëllimi” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

Neni 3, “Parime të përgjithshme” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

Në nenin 4 “Përkufizime” të ligjit nr.162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se: *“Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit”.*

Neni 21, “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksional sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për

mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj” në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.5.4. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë ato specifikime teknike për pajisjet objekt-prokurimi të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Gjithashtu, në shkresën me lëndë “Vendim” me nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021, drejtuar operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor ka sqaruar se përshkrimi i rezinës është bërë në një mënyrë që të kuptohet nga ofertuesit qëllimi i këtij elementi, si dhe është shënuar në dokumentet e tenderit, që çdo markë shoqërohet me fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, çka nënkupton se ofertuesit mund të disponojnë një material tjetër ekuivalent që të kryejë të njëjtin qëllim si ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në këtë rast, KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në fjalë në përputhje me nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, duke përshkruar specifikimin teknik për artikullin “rezinë” dhe duke mos shënuar asnjë emërtim marke.

Lidhur me pretendimin sa më sipër të ankimuesit të parashtruar në formën e kërkesës për sqarim *Ndërkohë në këtë projekt të ri kablli mund të mos jetë i po këtij tipi dhe kjo tip rezine mund të mos kryejë më këtë funksion. Ndaj duhet Drejtoria e Prokurimit ta sqarojë mirë këtë për të shmangur problematika në zbatimin e projektit*, KPP gjykon se autoriteti kontraktor e ka sqaruar ankimuesin me anë të shkresës me lëndë “Vendim” me nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021, drejtuar operatorit ekonomik ankimues. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kriterëve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre, e ka sqaruar ankimuesin në mënyrë shteruese mbi të gjitha pyetjet e ngritura, si dhe duhet të bëjë dhe publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 të LPP, i cili, parashikon

shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”, me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimin për dokumentet e tenderit, për të qenë i qartë e i saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...] në pikën 14 të Tabelës së Çmimeve, seksioni II, është kërkuar: F.v. Gilëza 110 kV me $S=(1 \times 1000) \text{ mm}^2 \text{ AL}$. Kjo është gilza që shërben për të bërë lidhjen e dejeve të kabllave brenda xhuntos. Çdo prodhues i ka këto gilza të dedikuara dhe me desing special, këto nuk janë universale. Pra gilzat e një tip xhuntoje të një prodhuesi nuk i shkojnë një xhuntoje të një prodhuesi tjetër.

Pyetja jonë është: te cili prodhues ta kërkojmë këtë tipin Gilze?

Sepse, na rezulton që kjo kërkesë të jetë diskriminuese pasi i dërgon të gjithë operatorët ekonomikë në vetëm 1 prodhues, atë që ka prodhuar xhuntot që ka gjendje OST që para 10 vjetësh dhe që ndoshta sot as që i prodhon më. Si ekspertë të fushës ju sigurojmë që nuk ka prodhues në botë që të furnizojë vetëm Gilzat siç kërkohet dhe kjo e bën ushtrimin praktikisht të pamundur. Ndaj duhet Drejtorja e Prokurimit ta sqarojë mirë këtë për të shmangur problematika në zbatimin e projektit. Nga sa më sipër kërkojmë rishikimin e kriterëve të veçanta për pranim-kualifikimin për procedurën e sipër cituar. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në dokumentet e tenderit, seksioni II, shtojca 2, “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, në **pikën 14** nga ana e autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë:

LISTA E ÇMIMEVE Nr.1:

Punime civile dhe elektrike per ndertimin e linjes kabllore Tirana 1 - Qendër

<i>Nr</i>	<i>Nr. Analizë</i>	<i>Përshkrimi i Punëve</i>	<i>Njësi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi/ Njësi</i>	<i>Çmimi total</i>

II. PUNIME ELEKTRIKE TE TERMINALEVE + MUFTAVE + TOKEZIMI I SKERMES SE KABLLOVE XLPE, AL, S11x1000) mm2						
14		F.v. Giléza 110 kV me S=(1x1000) mm2AL (morsete bashkuese kabllosh + aksesore)	Cope	15		

III.6.2. Në nenin 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë

apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje

faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt-kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

III.6.4. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendose kritere apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë ato specifikime teknike për mallra objekt-prokurimi të cilat nuk bien ndesh me parimet e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik apo me parashikimet e nenit 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Gjithashtu, në shkresën me lëndë “Vendim” me nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021, drejtuar operatorit ekonomik ankimes, autoriteti kontraktor ka sqaruar ndër të tjera se hartimi i

specifikimit teknik të gilzës është bërë sipas nevojave të vet AK për realizimin e kontratës. Autoriteti kontraktor nuk është shprehur në asnjë vend që pjesët e nevojshme për realizimin e kontratës të merren në një vend të caktuar ose të këtë të cilësuar ndonjë emërtim marke të mallit. Autoriteti kontraktor nuk mund të adresojë ofertuesit, se ku mund të kërkojnë për pjesët e nevojshme të parashikuara në specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kërkesa për “f.v Gileza 110kV” me S = (1x1000) mm² AL (morsete bashkuese + aksesorë), është sqaruar nga autoriteti kontraktor, pa cenuar saktësinë, qëllimin dhe rendimentin e punës, për të cilën është edhe qëllimi i prokurimit të mallit.

Lidhur me pretendimin sa më sipër të ankimuesit të parashtruar në formën e kërkesës për sqarim *Si ekspertë të fushës ju sigurojmë që nuk ka prodhues në botë që të furnizojë vetëm Gilzat siç kërkohet dhe kjo e bën ushtrimin praktikisht të pamundur. Ndaj duhet Drejtoria e Prokurimit ta sqarojë mirë këtë për të shmangur problematika në zbatimin e projektit*, KPP gjykon se autoriteti kontraktor e ka sqaruar ankimuesin me anë të shkresës me lëndë “Vendim” me nr. 5029/3 prot., datë 24.08.2021, drejtuar operatorit ekonomik ankimues. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për hartimin e kritereve kualifikuese dhe justifikimin për vendosjen e tyre, e ka sqaruar ankimuesin në mënyrë shteruese mbi të gjitha pyetjet e ngritura, si dhe duhet të bëjë dhe publikimin e sqarimit përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me nenin 75 të LPP, i cili, parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”,* me qëllim njohjen e të gjithë operatorëve ekonomikë ankimues me sqarimin për dokumentet e tenderit, për të qenë i qartë e i saktë për të gjithë të interesuarit për këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Aci Engineering” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-02824-08-13-2021, me objekt “*Ndërtimi i linjës kabllore 110 kV, Qendër - Tirana1 si dhe trakti 110 kV në funksion të kesaj linje*”, me fond limit 136,184,120 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzet) Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 31.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Aci Engineering” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fioorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj
	Kryetar	
	Jonaid Myzyri	